



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:250764

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05636614

KE.nr.285/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen kontestimore të paditësit Banka për Biznes (BPB) sh.a. me seli në Prishtinë të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Vlora Osmani avokate nga Prishtina Rr.”Tring Smajli” nr.4, kundër të paditurve: 1.) N.T.P.H “Banicom”, me NRB:80193599, me pronar F.Xh, me seli në Prishtinë, 2.) N.T.P.SH. “Aziz Komerc” me NRB:80258038, me pronar A.R., me seli në Pejë të dy të përfaqësuar nga avokat Agon Recaj si përfaqësues i përkohshëm dhe 3.) F.Gj. me numër personal ..., nga Prishtina të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Flutra Hoxha avokate nga Prishtina Rruga B, Royal C 13, H16/3, me objekt kontesti kthimi i borxhit të kredisë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, më datën 18.04.2024, në prani të autorizuarit të paditësit dhe të autorizuarve të paditurvet, ndërsa me datën 29.04.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Banka për Biznes (BPB) me të cilën ka kërkuar që detyrohen të paditurit 1) N.T.P.H “Banicom”, 2.) N.T.P.SH. “Aziz Komerc” dhe 3.) F.Gj., që në mënyrë solidare paditësit t’ia paguajnë shumën prej 143,888.00 euro, në emër të borxhit nga kontrata e kredisë, shumën prej 11,762.82 euro në emër të kamatës së rregullt, në shumën e përgjithshme prej 155,651.70 euro, dhe shumën prej 132,126.06 €, në emër të kamatë ndëshkuese, për shumën prej 143,888.00 euro me kamatë në lartësi si për mjetet e deponuara për një vit pa destinim të caktuar që paguhet në bankat komerciale në Kosovë, duke filluar nga data e vonesës se debitorëve deri në pagesën totale të borxhit në tërësi.

- II. Detyrohet paditësi që të paditurit të tretë F.Gj. t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 2,908.00 € ( dy mijë e nëntqind e tetë euro ).

### A r s y e t i m

Paditësi Banka për Biznes (BPB) sh.a. me seli në Prishtinë, me datën 12.05.2017, pranë Gjykatës Themelore Prishtinë, ka parashtruar padi kundër të paditurve 1.) N.T.P.H “Banicom”, me NRB:80193599, me pronar F.Xh, me seli në Prishtinë, 2.) N.T.P.SH. “Aziz Komerc” me NRB:80258038, me pronar A.R., me seli në Pejë dhe 3.) F.Gj. me numër personal ..., nga Prishtina, për kompensimin e borxhit nga baza e kontratës së kredisë. Ndër të tjerash ka theksuar se me të paditurit me datën 27.08.2003, ka nënshkruar kontratën e kredisë bankare dhe se të paditurit ishin të obliguar të lejnë peng pasurinë e tyre të luajtshme dhe të paluajtshme si garancion për kthimin e borxhit nga kontrata e kredisë. Sendet e luajtshme janë përbërë nga stoqet e mallit të specifikuara në listën e pengut të datës 14.07.2003. Po ashtu si mjet i sigurimit të kthimit të borxhit është lënë peng edhe banesa në pronësi të përfaqësuesit të Banikom, z.F.Xh dhe se marrëveshja për pengun është vërtetuar edhe në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Me qenë se palët e paditura nuk kanë kthyer borxhin nga kontrata e kredisë është detyruar që të inicioj procedurë gjyqësore për inkasimin e borxhit ku me datën 11.10.2014, ka iniciuar procedurën përmbartimore si dhe me datën 12.10.2019, propozim për vazhdimin e procedurës në drejtim të përmbartimit në paluajtshmërinë e lënë në hipotekë. I ka propozuar gjykatës që të detyrohen të paditurit që në mënyrë solidare të paguajnë në emër të kthimit të kredisë borxhin kryesor në shumë prej 143,888.00 euro, në emër të kamatës së rregullt shumë prej 11,762.82 euro, dhe në emër të kamatës për vonesë (kamatës ndëshkuese) shumë prej 132,126.06 euro në shumë e përgjithshme prej 287,777.76 euro.

Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Ekonomike, me Aktgjykimin EK.nr.267/17 të datës 09.11.2020, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesë padinë e paditësit Banka për Biznes (BPB) sh.a. me seli në Prishtinë të ushtruar kundër të paditurve 1.) N.T.P.H “Banicom”, me NRB:80193599, me pronar F.Xh, me seli në Prishtinë, 2.) N.T.P.SH. “Aziz Komerc” me NRB:80258038, me pronar A.R., me seli në Pejë dhe 3.) F.Gj. me numër personal ..., nga Prishtina.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse, me Aktvendim K.Dh.Sh.II.ne.835/2022 të datës 09.03.2023, ka aprovuar

ankesën e paditësit, ndërsa Aktgjykimin III.EK.nr.267/2017 të datës 09.11.2020, të Gjykatës së shkallës së parë, e ka prishur dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje.

Edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare e autorizuara e paditësit, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesës për kthimin e borxhit, të cilin borxh tani më e ka konfirmuar edhe ekspertiza financiare. Ndër të tjerash ka theksuar se nga provat e paraqitura është e vërtetuar se me datë 27.08.2003, palët kanë lidhur kontratën e kredisë me numër 226 në vlerë prej 185,000.00 euro, me afat kthimi prej 18 muajsh dhe kamatë fikse prej 14 %. Se borxhi nuk është kthyer dhe se kontrata nuk është respektuar këtë e ka konfirmuar ekspertiza financiare e datës 01.04.2020, e përpiluar nga eksperti R.B.. Në këtë rast ligji i aplikueshëm për shqyrtim të kësaj lënde është LMD e vitit 1987, ashtu siç është plotësuar dhe ndryshuar, ka theksuar se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka zbatuar dispozitën e nenit 371 të LMD-së kur ka konstatuar afatin 5 vjeçar për parashkrim të kërkesave, në rastin konkret nuk ka parashkrim të kërkesave kur merret për bazë ligji i sipër cekur. Po ashtu ka shtuar se paditësi ka ndjekur tri procedura të ndryshme përmbarimore, penale dhe kontestimore dhe në asnjërin prej këtyre proceseve nuk ka arritur afati i përgjithshëm apo i veçantë i parashkrimit, nëse e marrim për bazë propozimin për përmbarim e ka ndaluar parashkrimin e ka ndaluar parashkrimin dhe ky fakt dhe argument nga gjykata e shkallës së parë nuk është marr fare për bazë. Tutje ka shtuar se borxhi në fjalë që asnjëherë nuk është parashkruar rrjedh nga kontrata e kredisë ose kontrata e huas e cila në asnjë formë nuk mund të trajtohet si kontratë për mallra dhe shërbime dhe në këtë rast duke mos u cilësuar si e tillë sa herë që nuk ka dispozita të veçanta për afatin e parashkrimit, duhet aplikuar afati i përgjithshëm sipas LMD-së dhe se qëndrojnë në tërësi pranë precizimit në parashtresën e datës 30.11.2020.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka precizuar.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit të parë dhe të dytë ka deklaruar se mbetet edhe me tutje pranë përgjigjes në padi dhe deklarimeve nga seancat e kaluara në shqyrtimin paraprak gjyqësor dhe në këtë shqyrtim gjyqësor pas kthimit nga dhomat e shkallës së dytë, duke ritheksuar se vlerëson se kërkesëpadia e paditësit duhet të refuzohet si e pa bazuar për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit. Ka shtuar se nga kontrata e kredisë me numër 226, e datës 27.08.2003, si dhe nga plani i amortizimit të kredisë vërtetohet se kredia në shumën prej 185,000.00 euro është dhënë në afat të kthimit prej 18 muajsh apo 18 kësteve, ku kësti i parë ka qenë i paraparë që të kthehet me datë 12.10.2003, ndërsa kësti i fundit me datë 12.03.2005, dhe se në rastin konkret në kuptim të nenit 372, par.1

të LMD të vitit 1978, këstet e kredisë paraqesin pagesa periodike sepse të njëjtat kanë rrjedhur në afate periodike mujore apo thënë konkretisht në 18 këste mujore duke filluar nga data 12.10.2003 deri me datë 12.03.2005, dhe se në këtë rast afati ligjor për këto kërkesa është 3 vite që nga dita e arritjes për pagës dhe atë secili këst veç e veç, e ku me këtë rast del se kësti i parë i kredisë është parashkruar me datë 13.10.2006, ndërsa kësti i fundit me datë 13.03.2008 dhe mbi këtë bazë paditësi i është shuar e drejta që përmes procedurës gjyqësore të kërkoj përmbushjen e borxhit nga ana e të paditurve. Tutje ka theksuar se inicimi i procedurës përmbarimore E.nr.550/04 nga paditësi për inkasimin e kredisë nuk mund të konsiderohet si ndalje e afatit të parashkrimit dhe e gjithë kjo në kuptim të nenit 389, par.1 dhe 2 të LMD-së të vitit 1978, sepse në këtë çështje përmbarimore paditësi ka bërë tërheqjen e propozimit për përmbarim, i cili është aprovuar nga gjykata Themelore në Prishtinë dhe me aktvendimin me numër E.nr.550/04, të datës 08.11.2019, është konstatuar tërheqja e propozimit dhe janë abroguar të gjitha veprimet e ndërmarra përmbarimore. Nisur nga të gjitha faktet e theksuara më lartë vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është parashkruar për shkak se nuk është paraqitur brenda afatit ligjor prej 3 viteve.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare e autorizuar e të paditurit të tretë ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe pretendimeve në seancat e kaluara, ndër të tjerash ka theksuar se paditësi asnjëherë nuk e kishte njoftuar garantuesin- të paditurin e tretë për mos pagesën e kredisë e të paditurit të parë dhe të dytë. I padituri F.Gj. tek me datën 23.05.2018, kur ka pranuar padinë është njoftuar për herë të parë se F.Xh nuk e paska realizuar kredinë. Kontrata e kredisë është nënshkruar me datën 27.08.2003, kurse padia ndaj të paditurit të tretë është paraqitur në gjykatë me datë 30.05.2017, që do të thotë pas 14 vitesh. Dua të shtoj se i njëjti as procedurën përmbarimore të thirrur dhe përmendur nga paditësi nuk ka qenë palë në procedurë, prandaj paditësi as konform kontratës mbi kredinë e as konform dispozitave ligjore e njëjta me këtë mos veprim në afat ka shkaktuar shuarjen e të drejtës së padisë në kuptimin material. Ka shtuar se në këtë çështje juridike gabimisht është drejtuar procedura tek debitori i tretë ngase i njëjti nuk e ka cilësinë e debitorit solidar. Mungon faji, lidhja shkakore tek pjesa e dëmshme dhe meqenëse kemi të bëjmë me përgjegjësi solidarë atëherë dua të shtoj se kjo do të ishte vetëm nëse do të përcaktohej pjesa e dëmit të shkaktuar dhe në këtë rast garantuesi ka lidhur me bankën deklaratën garantuese vetëm për veturën e tij në vlerën prej 4.000.00 euro për çka këtu është përcaktuar pjesa e garancionit eventuale. Ka theksuar se i padituri i tretë do të duhej të lirohet nga kjo përgjithësi civile-juridik dhe padia ndaj të njëjtit fillimisht do të hudhet poshtë si e pa afatshme ose që gjykata të hedh poshtë padinë lidhur me të paditurin e tretë për shkak të legjitimitetit real-pasiv.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka precizuar.

Për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: Kontrata e Kredisë me numër 226, e datës 27.08.2003; Marrëveshja mbi Kolateralin (Pengun), e datës 27.08.2003; Kontrata mbi shitblerjen e banesës, datës 02.09.2000; deklarata garantuese e F.Gj., e datës 14.07.2003; Propozimi për ekzekutim të kolateralit, i datës 11.10.2004; Propozimi për vazhdimin e procedurës së përmbarimit i datës 12.10.2009; Konkluzioni mbi shitjen, datës 26.04.2011; Kallëzimi penal, i datës 12.10.2009; Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, datë 18.02.2014; Email, i datës 19.12.2018; kërkesa e Gjykatës Themelore në Prishtinë, e datës 10.04.2019, drejtuar ARBK-së; njoftimi nga ARBK, i datës 19.04.2019; ekspertiza financiare, e punuar nga eksperti R.B., e datës 01.04.2020; plotësim ekspertiza financiare, punuar nga ekspertit R.B., e datës 19.10.2020; Plani i amortizimit të kontratës për kredi Nr.226, të datës 27.08.2003.

Në këtë çështje juridiko-kontestimore Gjykata gjeti zbatim në dispozitat ligjore të parapara në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978) tutje LMD.

Gjykata duke vlerësuar pretendimet e të paditurve lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit, pas vlerësimit të shkresave të lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 372 dhe 373 të LMD-së, ka ardhur në përfundim se kërkesa e paditësit është parashkruar.

Në rastin konkret duke llogaritur afatin e rënies në vonës të kthimit të kredisë nga e paditura e parë që rrjedhë sipas kontratës së kredisë me numër 226 të lidhur më datën 27.08.2003, me afate të kthimit prej 18 muaj, dhe sipas planit të amortizimit është caktuar se kësti i parë pas lidhjes së kontratës ka arritur për pagesë më datën 12.10.2003 ndërsa kësti i fundit i cili ka arritur për pagesë është i datës 12.03.2005, rrjedhë se afati i fundit për kthim të kredisë ishte data 12.03.2005 e që e njëjta është parashkruar në kuptim të nenit 372, dhe 373 të LMD-së, pasi që padia e paditësit është parashtruar me datën 12.05.2017, ndërsa për kërkesat sipas dhënieve periodike sipas kontratës së kredisë kanë kaluar 12 vite e 3 muaj nga koha arritjes së kistit të fundit për pagesë e deri në momentin e paraqitjes së padisë, ashtu që ka kaluar afati prej 3 vitesh i përcaktuar në nenin 372 dhe afati prej 5 viteve i përcaktuar në nenin 373 të LMD-së.

Gjykata pati parasysh vërejtët e dhomave të shkallës së dytë dhënë sipas vendimit me të cilin rasti është kthyer në rigjykim çështje, se sipas nenit 371 të LMD-së, përcaktohet se *“Kërkesat parashkruhen për pesë vjet në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit.* Ndërsa me nenin 34 të Ligjit mbi ndryshimet dhe plotësimet mbi marrëdhëniet

detyrimore “Fletorja zyrtare e RFJ nr. 31/93 e datës 18.06 1993” i cili ka hyrë në fuqi me 25.06.1993, me të cilën është parashikuar se në nenin 371 të LMD fjala “pesë” zëvendësohet me fjalën “dhjetë” respektivisht në bazë të kësaj dispozite kërkesat parashkruhen për dhjetë vjet, nëse me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit, gjykata vlerëson se dispozita e përgjithshme mund të zbatohet vetëm në rastet kur nuk përcaktohet me dispozitë të veçantë, e që në rastin konkretë është përcaktuar me dispozitë të veçantë sipas nenit 372 të LMD-së prandaj afati i parashkrimit në këtë raste vlerësohet sipas dispozitës së nenit 372 të LMD, e që rezulton se afati i parashkrimit për çdo kërkesë periodike të kredisë është 3 vite ndërsa sipas dispozitës së nenit 373 të LMD 5 vite .

Sipas nenit 372 të LMD-së përcaktohet se “ *Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtëra (kërkesat periodike) si kur është fjala për kërkesat periodike akcesore, sikunder është kërkesa e kamatës, ashtu edhe kur është fjala për kërkesën periodike të atilla në të cilat sosit vetëm e drejta sikundër është kërkesa e ushqimit, parashkruhen tre vjet nga rrjedhja e secilës dhënie të veçantë për pagesë. E njëjta gjë vlen për anuitetet me të cilat në shuma të caktuara një herë përpara periodikisht. Paguhet kryegjësja dhe kamata, por nuk vlen për pagesat në kiste ose për përmbushje të tjera të pjeshme.*

Për më tepër sipas nenit 373 të LMD-së përcaktohet se “ *Vetë e drejta nga e cila rezultojnë kërkesat periodike parashkruhet për pesë vjet, duke llogaritur nga rrjedhja për pagesë e kërkesës më të vjetër të papërmbushur pas së cilës debitori nuk ka kryer dhënie. Kur parashkruhet e drejta nga e cila rezultojnë kërkesat periodike, atëherë kreditori humbë të të drejtën jo vetëm të kërkojë dhënie të ardhshme periodike që kanë rrjedhur për pagesë para këtij parashkrimi. E që në rastin konkretë sipas kësaj dispozite, rrjedhë se edhe vetë e drejta për paraqitjen e mjetit juridik për mbrojtje gjyqësore është parashkruar, pasi që ka kaluar afati prej 5 viteve, brenda të cilit afatë kohorë paditësi ka mundur të ushtroj mjet juridik për mbrojtje gjyqësore.*

Gjykata vlerësoj edhe pretendimet e palës paditëse lidhur me ndërprerjen e parashkrimit por sipas vlerësimit të kësaj gjykatë, propozimi për përmbarim i parashtruar nga pala paditëse në Gjykatën Komunale në Prishtinë, në drejtim të ekzekutimit të borxhit nga banesa e lënë në hipoteke, nuk e ka ndërprerë rrjedhën e afatit të parashkrimit. Kjo për faktin se me aktvendimin E.nr.550/04, të datës 08.11.2019, të nxjerre nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Divizioni Civil, propozimi për përmbarim është konstatuar i tërhequr. Prandaj bazuar në nenin 389 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, ku është e paracaktuar se “*Ndërprerja e parashkrimit e bërë me ngritjen e*

*padisë ose me ndonjë veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose organit tjetër kompetent me qëllim përcaktimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës, konsiderohet se nuk ka filluar po që se kreditori heq dore nga padia ose veprimi që ka ndërmarrë,” si dhe në paragrafin 2 është parapare se "konsiderohet se nuk ka pasur ndërprerje të parashkrimit në qoftëse se padia e kreditorit ose kërkesa e tij hidhet pashë apo refuzohet, ose në qoftëse se anulohen masat e siguruara ose të ndërmarra në drejtim të ekzekutimit apo të sigurimit”, gjykata ka ardhur në përfundimin se propozimi për përmbarim nuk e ka ndërprerë rrjedhën e afatit të parashkrimit të kërkesës, ngase me aktvendimin me të cilin ishte konstatuar i tërhequr propozimi për përmbarim janë anuluar të gjitha veprimet procedurale të ndërmarra në atë procedurë. Rrjedhimisht duke u bazuar në dispozitën e lartë cekur gjykata ka ardhur në përfundimin se këto veprime nuk e kanë ndërprerë rrjedhën e afatit të parashkrimit të kërkesës së palës paditëse, pasi që pas tërheqjes së propozimit për përmbarim, konsiderohet si të mos jenë paraqitur as një herë.*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat dhe dispozitat ligjore të cituara, ka ardhur në përfundim se kërkesa e paditësit është e parashkruar, andaj edhe është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gjykata i shqyrtoi edhe provat tjera të administruara, mirëpo meqenëse kërkesëpadija e paditësit është parashkruar vlerësoi se provat tjera të administruara janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike kontestimore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së, në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i paditësit, i referohen shumës së precizuar si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga i padituri dhe atë: për përpilimin e përgjigjes në padi shumën prej 208.00 € për përfaqësim në 12 seanca gjyqësore për 4 seanca e shtyra shumën me nga 135.00 € dhe 9 seanca të mbajtura shumën me nga 270.00€, në shumë të përgjithshme prej 2,908.00€

Nga arsyet e cekura më lart, në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.285/23, datë 29.04.2024

Gjyqtari

Gent Bekeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.